

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children



Ofrimi i granteve direkte për pushtetin vendor për të mundësuar mjedise mbështetëse për promovimin e shëndetit

Në vitin 2022, Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka ofruar grante direkte për bashkitë Korçë, Has, Kukës, Maliq dhe Gramsh për një sërë ndërhyrjesh në promovimin e shëndetit.



“Nevruz Vila” School, Maliq Municipality



“Helshan” School, Has Municipality



“Nuçi Naçi” School, Korça Municipality



“Lidhja e Prizrenit” School, Kukës Municipality

Përveç bashkive, Projekti “Shkollat për Shëndetin” aktualisht po mbështet dhënie e granteve/kontratave të drejtpërdrejta për organizatat lokale të shoqërisë civile (OSHC) dhe aktorë të tjerë të ndryshimit (individë dhe grupe individësh) në nivel vendor, me qëllim realizimin e aktiviteteve për promovimin e shëndetit.



Lexo më shumë

Koordinatorët e shëndetit të shkollave si agjentë kryesorë të ndryshimit për ndërhyrje të qëndrueshme në promovimin e shëndetit

Projekti "Shkollat për Shëndetin" po shqyrton aktualisht nevojën urgjente për të ngritur dhe forcuar rolin dhe përgjegjësitë e "Koordinatorëve të Shëndetit" në nivel shkollash në Shqipëri, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët e përfshirë. Pozicioni i "Koordinatorit të Shëndetit" konsiderohet thelbësor për të siguruar praninë e një personi të dedikuar në çdo shkollë, i cili duhet të jetë përgjegjës për koordinimin dhe harmonizimin e përgjithshëm të programeve të promovimit të shëndetit që zbatohen në shkolla.








Lexo më shumë

Akses i gjerë për rritjen e kapaciteteve të stafit të shkollave dhe specialistëve të promovimit të shëndetit në nivel vendor përmes trajnimit

Aktualisht, ofrohen shtatë module trajnimi të aksesueshme nëpërmjet platformës e-learning, të cilat janë akredituar zyrtarisht nga ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar) me nga një kredit për secilin modul. Modulet e trajnimit ofrohen pa pagesë nga projekti dhe çdo anëtar i stafit të shkollës që përfundon me sukses modulin pajiset një kredit të njohur nga ASCAP. Në periudhën Mars-Gusht 2022, 439 përdorues (mësues dhe personel i shkollës) janë trajnuar online.

Për informacion më të detajuar mbi modulet e trajnimit mund të aksesoni platformën e-learning në [Shkollat Për Shëndetin \(shkollatpershendetin.al\)](http://Shkollat Për Shëndetin (shkollatpershendetin.al)).

| | | | | |
|---|---|--|---|---|
|  <p>Axhenda - 22GJ105 Rëndësia e aktivitetit fizik dhe 6-16 shëndeti të nxënësit e moshës vjeç, për të promovuar një stil jetese të shëndetshme.</p> |  <p>Axhenda - 22GJ188 Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm në kurrikulën shkollore të grupmoshës 6-16 vjeç.</p> |  <p>Axhenda - 22GJ106 Promovimi i rëndësisë të shëndetit mendor të nxënësit e moshës 6-16 vjeç.</p> |  <p>Axhenda - 22GJ107 Edukimi seksual gjithëpërfshirës.</p> |  <p>Axhenda - 22GJ108 Higjiena personale, parandalimi i sëmundjeve infektive të nxënësit e moshës 6-16 vjeç dhe mbrojtja e mjedisit.</p> |
|---|---|--|---|---|

Kurse trajnimi të akredituara nga ASCAP



Lexo më shumë

Fushata e Karvanit të Shëndetit

Rajoni i Durrësit, Lezhës dhe Beratit janë përzgjedhur për ndërhyrje të thelluara në vitin e dytë të zbatimit (Mars 2022 – Shkurt 2023) të projektit “Shkollat për Shëndetin”. Fushatat për promovimin e shëndetit kanë patur një ndikim pozitiv në perceptimin e fëmijëve, prindërve dhe mësuesve për zgjedhjen e një stili jetese të shëndetshme. Nëpërmjet ndërhyrjeve në terren në rajonet e zgjedhura, kanë përfituar rreth 13,000 fëmijë.



Fushata e Karvanit të Shëndetit, Rrëshen, Maj 2022



Panairi i Ushqimit, Bishqem, Mars 2022



Lexo më shumë

Përfshirja e prindërve në promovimin e stilit të shëndetshëm të jetesës, praktikave të mira higjienike dhe mjediseve të sigurta

Fushata e Prindërimit Pozitiv ka përfshirë 813 prindër (92% e të cilëve gra, 11% prindër romë ose egjiptianë dhe 26% që marrin ndihmë financiare. Prindërit e përfshirë në këtë aktivitet të projektit morën pjesë në një sërë aktivitetesh që promovonin stil të shëndetshëm jetese, si higjiena e duhur dhe praktikat e sigurta mjedisore.

Fushata e Prindërimit Pozitiv ka sjellë një rritje në përqindje të numrit të prindërve dhe kujdestarëve që përgatisin ushqime të shëndetshme në shtëpi me 12% dhe të atyre që u japin ushqim fëmijëve për të ngrënë në shkollë, me 11%.



Prindërimi Pozitiv, Durrës, Gusht 2022



Lexo më shumë

Kontributi për përfshirjen e komuniteteve në nevojë, zonave rurale, fëmijëve/prindërve/kujdestarëve me aftësi të kufizuara si dhe familjeve që i përkasin skemës së ndihmës ekonomike.

Të gjitha shkollat e përzgjedhura për ndërhyrje të thelluara në vitin e dytë të projektit, ishin të vendosura në zonat urbane, periurbane dhe rurale, si dhe në komunitete vulnerabël (minoritetet rome/egjiptiane, apo zona të varfra të vendit).

Gjatë periudhës Mars-Gusht 2022, vetëm përmes ndërhyrjeve të thelluara (online), projekti ka prekur personat e mëposhtëm vulnerabël, përqindja e të cilëve mes përfituesve të projektit është dukshëm më e lartë krahasuar me popullsinë e përgjithshme në Shqipëri:

- Fëmijë romë/egjiptianë: 342 (169 vajza dhe 173 djem);
- Fëmijë nga familjet e varfra: 741 (354 vajza dhe 387 djem);
- Fëmijët me nevoja të veçanta: 72 (36 vajza dhe djem 36 djem);
- Prindër/kujdestarë romë/egjiptianë: 85 (79 femra dhe 6 meshkuj);
- Prindërit/kujdestarët veçanërisht të varfër: 210 (189 femra dhe 21 meshkuj).

Aplikacionet Digjitale dhe Konkursset Digjitale të Shëndetit

Pas optimizimit të pesë aplikacioneve Android të zhvilluara në vitin e parë, në vitin e dytë, projekti "Shkollat për Shëndetin" ka zhvilluar pesë aplikacione edhe në iOS: "Jo Sheqerit", "Qëndro Aktiv", "Ushqehu Shëndetshëm", "Praktikat e Higjenës së mire" dhe aplikacioni për fëmijët me nevoja të veçanta. Aplikacionet mund të shkarkohen nga: [Shkarko programet – Shkollat për Shëndetin](#).

iPhone



Koronavirus SHPSH
Education



Fëmijë Special
Education



Jo Sheqerit
Education



Ushqehu Shëndetshëm
Education



Qëndro Aktiv
Education

Gjithashtu, në kuadër të projektit janë organizuar 80 konkurse Digjitale të Shëndetit ndërmjet grupeve të ndryshme të fëmijëve në mjedise të ndryshme në rrethet Tiranë, Lezhë, Elbasan dhe Korçë, nga të cilat 25% u zhvilluan në zonat rurale.



Konkursi Digjital i Shëndetit, Tiranë



Lexo më shumë

Forcimi i kapaciteteve të shkollave për promovimin e shëndetit të fëmijëve

Krijimi i "Klubeve të shëndetit" dhe "Qendrave burimore" në shkolla ka promovuar ndryshime pozitive të sjelljes përmes demonstrimeve praktike, video-prezantimeve, lojërave të ngjashme, etj. Krijimi i klubeve të shëndetit/qendrave burimore ka rritur mundësitë për realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore si organizimi i Konkurseve Digjitale të Shëndetit etj.



Qendra Burimore Shkolla "Zihni Toska", Berat



Lexo më shumë